



URDHËR

Nr. 79, datë 8.7.2011

MBI ZBATIMIN E UDHËZIMIT NR. 22, DATË 06.07.2011 TË MASH "PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT, TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, VITI AKADEMIK 2011 - 2012"

Në bazë të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2010 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 39 të Statutit të Akademisë së Arteve si dhe UMASH Nr. 2, datë 06.07.2011;

URDHËROJ

1. Pranimet në vitin akademik 2011 – 2012 në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në Universitetin e Arteve (UART), bëhen në bazë të rezultateve të Maturës Shtetërore dhe rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, i organizuar nga UART.
2. Numri maksimal i pikëve të konkursit, për të gjitha programet e studimit të UART është 240 pikë, sipas përcaktimit nga MASH.
3. Numri minimal i pikëve të konkursit, për të gjitha programet e studimit të UART është 60 pikë, sipas përcaktimit nga MASH. Kandidati që nuk kalon pragun e pikëve minimale të konkursit të pranimit, nuk fiton të drejtën e studimit.
4. Në të gjitha programet e studimit në UART, rezultatet e shkollës së mesme llogariten në masën 30% dhe rezultatet e konkursit të pranimit në masën 70%. Me rezultate të shkollës së mesme do të kuptohet nota mesatare e katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore.
5. Kandidatët që kanë kërkuar në Formularin A2, programet e studimit në UART, si edhe kandidatët shqiptarë që do të marrin pjesë në konkurset e pranimit për këto programe studimi nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Lugina e Preshevës, regjistrohen për zhvillimin e konkursit pranë sekretarisë



mësimore të Fakultetit përkatës. Periudha e regjistrimit është nga data 16 Gusht 2011 deri në orën 12.00 të datës 27 Gusht 2011.

6. Lista e konkurrentëve për konkurset e pranimit do të jetë lista e dërguar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP). AKP dërgon listën në datën 15 Gusht 2011, në formë të shkruar dhe elektronike. Lista e konkurrentëve nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Lugina e Preshevës, dërgohet nga MASH.
7. Dekanatet e Fakulteteve të UART, me qëllim ecurinë normale të procesit të regjistrimeve në konkurset e pranimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, shpallin në mjediset të dukshme të Fakulteteve përkatëse deri në datën 10 Gusht 2011, të dhënat e mëposhtme:
 - i. Datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit;
 - ii. Procedurat e regjistrimit;
 - iii. Listën e dokumenteve të nevojshme.
8. Sekretaritë mësimore të Fakulteteve të UART verifikojnë deri në datën 27 Gusht 2011 përputhshmërinë e listës së kandidatëve të regjistruar për konkurim me listën e dorëzuar nga AKP.
9. Në datën 27 Gusht 2011, ora 12.00, Sekretaritë mësimore të secilit Fakultet të UART shpallin listat e konkurrentëve të regjistruar dhe i afishojnë ato në vende të dukshme, në mjediset e Fakulteteve përkatëse.
10. Data e konkurseve të pranimit në UART janë si më poshtë:
 - i. 29 Gusht deri 2 Shtator 2011, për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Muzikës;
 - ii. 29 Gusht deri 2 Shtator 2011, për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Artit Skenik;
 - iii. 29 Gusht deri 2 Shtator 2011, për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Arteve të Bukura.
11. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkurset e pranimit në të gjitha programet e studimit të UART është 5.000 (pesë mijë) lekë.
12. Tarifat e regjistrimit për konkurim sipas pikës 11 të këtij urdhri, arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose zyrës së postës shqiptare, për llogari të Akademisë së Arteve.
13. Konkurset e pranimit në UART do të monitorohen nga përfaqësues të Rektoratit dhe MASH-it. Të gjitha strukturat e UART do të ofrojnë përfaqësuesve monitorues të Rektoratit dhe MASH-it, të gjithë ndihmën e nevojshme në ushtrimin e detyrës së tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKADEMIA E ARTEVE
REKTORATI

14. Rezultatet e konkurseve të pranimit në UART i dërgohen MASH dhe AKP, në formë të shkruar dhe në formë elektronike (CD) brenda tre ditëve nga përfundimi i konkurseve.
15. UART shpall listën e kandidatëve fitues nga Republika e Kosovës, në përputhje me kuotat e miratuara për çdo program studimi.
16. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Dekan e Fakulteteve të UART, Sekretaritetë Mësimore, Kancelarja e UART dhe Drejtoria Ekonomike.
17. Çdo strukturë mësimore apo administrative e UART zbaton detyrat që rrjedhin nga ky urdhër dhe Udhëzimi i MASH nr. 22, datë 06.07.2011, në përputhje me urdhërimet e personave dhe strukturave të përcaktuar në pikën 16 të këtij urdhri, sipas varësisë.
18. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

